

**Mundësi punësimi:**  
**Avokat/e pranë Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare**

Tiranë, më 25.06.2020

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare njofton të gjithë personat e interesuar se shpall pozicionin vakant për avokat/e on line<sup>1</sup> për periudhën Korrik 2020 – Prill 2021.

Avokati do të ofrojë ndihmë juridike parësore për të mbijetuarat/it nga dhuna me bazë gjinore pavarësisht vendbanimit të rastit në zona rurale apo urbane, në të gjithë vendin.

Ndihma juridike parësore do të realizohet nëpërmjet komunikimit me telefon, email, facebook, web e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare dhe/ose web e Rrjetit të Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore dhe/ose platforma on line.

**Kandidatët duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:**

- Të kenë përfunduar studimet për drejtësi, të barazvlefshme me sistemin Bachelor plus Master;
- Të jenë pajisur me licensën e avokatit/es;
- Të njohë programet bazë të kompjuterit si dhe platformat on line, me qëllim ofrimin on line të ndihmës juridike parësore.

**Preferohen:**

- Të kenë eksperiencë pune në ushtrimin e profesionit të avokatit;
- Të kenë pasur eksperiencë si anëtarë/e të skuadrave pro-bono pranë Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare;
- Të kenë pasur eksperiencë si avokat/e në çështje familjare, të dhunës me bazë gjinore dhe diskriminimit gjinor;
- Të kenë pasur eksperiencë pune pranë organizatave jofitimprurëse që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut;
- Të kenë njohuri të gjuhës angleze;

Në përputhje me Nenin 142/2 të Kodit të Punës, të ndryshuar, muaji i parë i punës do të konsiderohet si kohë prove.

Me qëllim aplikimin në këtë pozicion kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin si vijon:

1. CV e kandidatit/es;
2. Kopje të Diplomës, të shoqëruar me kopje të listës së notave të studimeve Bachelor dhe Master, ose ekuivalente me to;
3. Dëshmia e licencës së Avokatit;
4. Dokument që provon njohuritë e gjuhës angleze, nëse ka një dokument që provon njohuritë;
5. Çdo dokumentacion të nevojshëm që tregon kualifikimet e kandidatit/es;

**Afati i fundit i aplikimeve do të jetë dita e premte, data 10 Korrik 2020, ora 16.00.**

Dokumentacioni mund të dërgohet i skanuar në adresën e emailit [avokatore2@yahoo.com](mailto:avokatore2@yahoo.com) ose, të depozitohet pranë zyrave të Qendrës për Nisma Ligjore me adresë Rruga “Vaso Pasha” Pll.12, Shk.1, Ap. 1 Tiranë.

Kandidatët e shortlistuar mund të njoftohen dhe thirren në një intervistë.

---

<sup>1</sup> Ky pozicion është parashikuar në kuadrin e zbatimit nga QNL të projektit “Mbështetja e Rrjetit të Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore në përgatitjen e raporteve alternative për CEDAW dhe GREVIO dhe draftimin e një Strategjie të re për Barazinë Gjinore”.